



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1135/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Glllogocit- Drejtorati për Buxhet dhe Financa, kundër debitorit Qeveria e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPP.nr.667/2020 të datës 22.05.2023, me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Glllogocit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.667/2020 i datës 22.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar KPP.nr.667/22 të datës 22.05.2023, ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, ka anuluar Urdhri përmbarimor P.nr.7/2021 të datës 22.01.2021, të lejuar nga përmbaruesi privat Hakif L. Hasi, dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e autorizuar e kreditorit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që aktvendimi i ankimuar të prishet dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Glllogocit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, me datë 22.01.2021 ka paraqitur propozim për përmbarrim kundër debitorit Qeveria e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr.14/2020 të datës 30.11.2020, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 112,143.37 Euro.

Përmbarruesi privat Hakif L. Hasi, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.7/2021 të datës 22.01.2021, ka lejuar përmbarrimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.14/2020 të datës 30.11.2020, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbarrim.

Kundër këtij urdhri përmbarrimor debitori me datë 05.02.2021 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se të hyrat e krijuara nga qiraja në Parkun e Biznesit kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës pranë Departamentit të Thesarit në Ministrinë e Financave dhe jo tek debitori siç pretendon kreditori, pasi që debitori nuk është përgjegjës për shpërndarjen e mjeteve, andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar propozimi për përmbarrim dhe të anulohen të gjitha veprimet e marra nga ky urdhër përmbarrimor.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 16.02.2021, duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit, me arsyetimin se urdhri është lëshuar në bazë të dokumentit të besueshëm faturës dhe si e tillë është e lejuar që të përmbarrrohet. Ky detyrim është krijuar me një punë të vlefshme juridike Memorandumi për Mirëkuptim i cili prodhon efekte juridike nga dita e nënshkrimit. Andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të vërtetohet si i bazuar urdhri për përmbarrim P.nr.7/2021 i datës 22.01.2021 i përmbarruesit privat Hakif L.Hasi.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPP.nr.667/2022 të datës 22.05.2023, me të cilin ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, ka Anuluar urdhrin përmbarrimor P.nr.7/2021 të datës 22.01.2021, të lejuar nga përmbarruesi privat Hakif L. Hasi, dhe ka përfunduar në tërësi përmbarrimin në këtë çështje përmbarrimore.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, për faktin se fatura nr.14/2020 e datës 30.11.2020 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret fatura është dorëzuar përmes parashtresës drejtuar MTI-KIESA e cila përmban vulën e pranimit me protokoll numër 8864 të datës 30.11.20, ndërsa debitori në këtë rast MTI përmes parashtresës e cila e përmban vulën e protokollit të kreditorit 03 nr. 400/01-53690, e ka kundërshtuar faturën dhe kreditorin e ka udhëzuar që kërkesën e tij ta realizoj

pranë Ministrisë së Financave si menaxhere e buxhetit të Republikës së Kosovës. Meqenëse debitori e ka kundërshtuar faturën, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk është bërë dorëzim i rregullt i faturës dhe e njëjta nuk mund të shërbej si dokument përmbarimor në këtë çështje përmbarimore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura pjesë e propozimit për përmbarim, e lëshuar nga ana e kreditorit nuk është pranuar nga debitori. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çequet me potest dhe **faturë kthyesë**, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”,* kurse me paragrafin 3 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.*

Mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore, kjo gjykatë vlerëson se Dhomat e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura (si në propozim) si dokument i besueshëm mbi të cilën është iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nuk është pranuar nga debitori i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Që nënkupton se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e

dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se me rastin e mos kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lëndë i është shkaktuar çfarëdo lloji dëmi, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase pretendimet e tilla të paraqitur në këtë procedurë përmbarimore, nuk paraqet bazë ligjore për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës si në propozim.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore të palës ankuese, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së dytë  
K.DH.SH.II nr.1135/2023, me datë 25.03.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha